



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.635/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Adnan Konushevi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me seli në Suharekë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.635/2021 e datës 17.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me seli në Suharekë, ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Suharekë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021 të mbajtura me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2021, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Suharekë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në afërsi të qendrës së votimit 2407A, në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës ka qëndruar një veturë në afërsi prej 20-30m, me përmbajtje elektorale, me numër dhe fotografi të kandidatit për kryetar të kësaj partie, të cilët me këtë veprim kanë thyer heshtjen zgjedhore duke bërë thirrje që të votohet subjekti i tyre dhe kandidati për kryetar nga radhët e subjektit politik të AAK-së. Me këtë rast paraqitësi i ankesës ka pretenduar se më këtë veprim subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe rregullat zgjedhore, e njëjta kërkon nga PZAP-i që të sanksionohet me legjislacionin në fuqi subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2021, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, thekson se nuk shihet qartë fotografia e kandidatit e cila është vendosur në veturë, as qendra e votimit ku pretendon ankuesi. Të njëjtit theksojnë se fillimisht ankuesi ka theksuar se shkelja ka ndodhur me datën 16.10.2021 në orën 12:00, ndërsa në korrigjimin e ankesës pretendojnë se shkelja e supozuar ka ndodhur me datën 17.10.2021 në orën 12:00,

prandaj i propozojnë PZAP-it që këtë ankesë ta hedhë poshtë si të pasafatshme, ose të refuzoj si të pa bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik LVV, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në afërsi të qendrës së votimit 2407A, në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës ka qëndruar një veturë në afërsi prej 20-30m, me përmbajtje elektorale, me numër dhe fotografi të kandidatit për kryetar të kësaj partie, të cilët me këtë veprim kanë thyer heshtjen zgjedhore. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit AAK, për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik AAK me datë 17.10.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provës së bashkëngjitur në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik LVV– Dega në Suharekë, ndaj subjektit politik AAK – Dega në Suharekë, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, është i pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik LVV, pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur ti mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre si provë kanë bashkëngjitur fotografi, por e njëjtat nuk dëshmojnë se kjo shkelje ka ndodhur në afërsi të qendrës së votimit 2407A, dhe ky pretendim mbetet vetëm nivel pretendimesh dhe pa prova konkrete sepse nga fotografia e njëjtë nuk shihet qartë as vendi, numri i subjektit dhe kandidati siç pretendohet në ankesë.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.635/2021 më datën 18.10.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllëgjani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së

